



Vjetari
2024/25

20
VJET ALG



Loyola Campus

Shkolla Fillore
Gjimnazi
Konvikti
Loyola-Profesionale



www.alg-prizren.com



***“Arsimi është arma më
e fuqishme që mund
ta përdorësh për të
ndryshuar botën.”***

Nelson Mandela

Përmbajtja

1. HYRJJE

1.1 Stefan Mette.....	2
1.2 Blerand Koshi.....	3
1.3 M. Lindita Spaqi.....	4
1.4 Bashkim Rrezja.....	5

2. JETA NË ALG

2.1 Mirëseardhja e nxënësve të klasave të para në Loyola-Fillore - një fillim që mbush zemra	7
2.2 Dita e Dyerve të Hapura në Loyola Fillore	8
2.3 Kujtime dhe mësim - Ditët tematike që ndriçuan vitin shkollor në Loyola Fillore	10
2.4 Festa e Abetares - Mbretëria e Shkronjave	12
2.5 Java e Sportit në Loyola-Fillore - Lëvizje, energji dhe bashkim	13
2.6 Një javë frymëzimi: Miss World England dhe Festa e Gjuhës Angleze në Loyola Fillore	14
2.7 Loyola dhe libri: Dy klube, një frymë e përbashkët	15
2.8 Festat e fundvitit në ALG - Një magji e përbashkët në Fillore, Gjimnaz dhe Konvikt	16
2.9 Një ëndërr që rreh prej 20 vitesh Historia e Loyola-Gymnasium, e shkruar me zemër	18
2.10 Matura BBQ Party - Nata që mbetet përjetë	20
2.11 Diplomimi 2024–2025: Një mbrëmje gëzimi, mirënjohjeje dhe fillimesh të reja në Loyola.....	21
2.12 Jeta në Loyola-Konvikt - Shtëpia e dytë ku rriten miqësia, kreativiteti dhe vetëbesimi.....	22
2.13 Inovacion dhe qëndrueshmëri - Loyola-Profesionale në projektin TtraSE	23
2.14 Kurse afatshkurtra në Loyola-Profesionale	24
2.15 Diplomimi i gjeneratës së dytë në Mekatronikë	25

3. MËSIMI PËRTEJ KLASËS

3.1 Mësimi përtej klasës - Përvoja që rrisin fëmijët tanë	27
3.2 Udhëtimet e Loyola Fillore që mësojnë, gëzojnë dhe lidhin fëmijët me natyrën	28
3.3 Në Krushë të Madhe dhe Rahovec: një ditë mësimi, reflektimi dhe përjetimesh të reja	29
3.4 Magjia e skenës dhe ekranit - Përvoja që ushqejnë imagjinatën.....	30
3.5 Një vizitë që preku zemrat Loyola-Gymnasium në Down Syndrome Prizren	31
3.6 Në gjurmët e ujit - Një mësim i gjallë për jetën dhe përgjegjësinë	32
3.7 Loyola-Gymnasium në Trepçe – Një ditë që ndriçoi dijen.....	32
3.8 Një Ditë Skijimi për Nder të Pavarësisë - Liria që festohet me lëvizje	33
3.9 Loyola-Konvikt - Aventurat që lidhin fëmijët me natyrën dhe me njëri-tjetrin	34
3.10 Shkolla e mesme “11 Marsi” dhe Loyola-Fillore vizitojnë Loyola-Profesionale	35

4. BASHKËPUNIMET

4.1 ALG dhe Ambasada Gjermane - Kur kultura, miqësia dhe rinia bashkojnë dy vende	37
4.2 Pedagogjia ignaciane në zemër të shkollës sonë	38
4.3 Ekspertiza gjermane në ALG	39
4.4 Loyola & Hildesheim - Kur profesionistët rriten së bashku dhe kulturat bashkohen	40
4.5 Një ditë e paharrueshme me MSU KFOR	41
4.6 Nga Prizreni në Mostar – Një udhëtim që ndërton ura, kujtime dhe paqe	41
4.7 Iniciativa e aftësimi profesional në Gjimnazin Loyola – Rrugëtimi i përbashkët drejt karrierës	42
4.8 Miqtë dhe përkrahësit e Asociation “Loyola-Gymnasium” e. V.	43
4.9 Tri javë përvoja dhe frymëzimi në Thüringen	44
4.10 Një javë që ndërtoi ura: Shkëmbimi ndërkulturor Gemünden–Prizren	44
4.11 Vullnetarizmi në veprim - Nxënësit e Loyola-Gymnasium në shërbim të komunitetit	45

5. ALG PËR KOMUNITETIN

5.1 “Kursejmë dhe dhurojmë” - Një mësim i vogël me dashuri të madhe	47
5.2 Loyola-Fillore promovon sportin për një botë më të gjelbër	48
5.3 “Unë ushqehem, tjetrin ndihmoj” – Një mësim zemre dhe solidariteti	49
5.4 Për një buzëqeshje më shumë - Vizita e nxënësve në shtëpinë e të moshuarve	50
5.5 Këndi i Mirësisë - Kur gjetet e vogla krijojnë ndryshime të mëdha	51
5.6 Muaji Rozë në Loyola-Gymnasium - Kur ndërgjegjësimi bëhet vepër	52
5.7 Loyola-Konvikt: Mirësia që udhëton nga zemra te zemrat e fëmijëve në nevojë	53

6. PROJEKTET E ALG-SË

6.1 Muzikë në kohë të lirë - Hapësira ku talentet marrin jetë	55
6.2 Ditët e Karrierës - Kur e ardhmja fillon sot	56
6.3 Gara e Vallëzimit - Kur pasioni bëhet art në lëvizje	57
6.4 Loyola Talks - Fjalët që frymëzojnë	58

7. EKSKURSIONET

7.1 Ekskursioni i Maturantëve 2024/2025 – Udhëtimi i fundit që mbetet përgjithmonë	61
7.2 Loyola në Romë - Një udhëtim që ngjyrosi mendjen dhe shpirtin	62

8. ALG STARS

8.1 Elina Lutfiu – Zëri që ngriti flamurin e Kosovës	65
8.2 Klea Velu – Nga Loyola drejt një të ardhmeje ndërkombëtare	65
8.3 Kampionë në Futsal – Kur pasioni dhe ekipi shkruajnë histori	66
8.4 Kampionë Komunale në Volejbol – Forca që frymëzon	66
8.5 Jora dhe Vesa – Zërat që sollën gjermanishten në skenë	67
8.6 Shkëlqim i dyfishtë në Kimi dhe Ekonomi – Yjet e Loyola-Gymnasium!	68
8.7 Klea Çoçaj dhe Lea Shehu -Dy yje të Loyola-Gymnasium fitojnë bursën prestigjioze YES	69



Stefan Mette

Kryetar i bordit të ALG-së

Të dashur lexuese dhe lexues të vjetarit tonë,

Prej 20 vitesh, institucioni ynë me shkollat dhe konviktin e tij është pjesë e Prizrenit dhe Kosovës. Ne jemi krenarë për këtë rrugëtim – një arritje që i dedikohet shumë kontribuuesve brenda dhe jashtë vendit: shoqatave, fondacioneve, organizatave, individëve. Në emër të ALG-së, ju shpreh mirënjohjen time më të sinqertë për këtë mbështetje!

ALG është rritur dhe është shndërruar në një institucion të njohur dhe të respektuar në Republikën e Kosovës – i mbështetur fuqishëm nga Shoqata Mbështetëse me bordin e saj dhe nga punonjësit tanë në Prizren. Së bashku sigurojmë një mjedis të shkëlqyer mësimor, programe arsimore të larmishme e moderne, stabilitet dhe cilësi në çdo hap. Fokusi ynë janë nxënësit tanë në Kosovë: ata pajisen në ALG me kompetenca dhe vlera që u mundësojnë të ndjekin rrugën e tyre – në të mirë të vendit të tyre dhe të botës – me parime të forta për një bashkëjetesë paqësore dhe me përgjegjësi, pavarësisht prejardhjes apo besimit.

Ju ftojme sinqerisht:

Të vazhdoni edhe në të ardhmen, sipas mundësive tuaja, të kontribuoni në zhvillimin e ALG-së dhe në forcimin e përgjegjësisë sociale në Kosovë. Ndërkohë, ju ftojme të hidhni një vështrim së bashku me ne mbi një vit shkollor plot përvoja dhe angazhime.

Me përshëndetje të ngrohta,

Stefan Mette
Kryetar i Bordit



Blerand Koshi

Drejtore i “Loyola-Gymnasium”

Të dashur nxënës, prindër, kolegë dhe miq të Loyola-Gymnasium,

Në këtë vit jubilar, kur festojmë 20 vjetorin e themelimit të shkollës sonë, ndjej një krenari të veçantë për rrugëtimin që kemi bërë së bashku. Loyola-Gymnasium nuk është thjesht një institucion arsimor, është një komunitet ku dijet, vlerat dhe njerëzit bashkohen për të ndërtuar të ardhmen.

Gjatë këtyre dy dekadave, kemi arritur shumë: kemi formuar breza të rinj që sot kontribuojnë me sukses në Kosovë dhe më gjerë, kemi krijuar një kulturë të fortë të mësimin dhe respektit, dhe kemi ndërtuar një emër që lidhet me cilësi dhe integritet. Kjo histori suksesi është rezultat i përkushtimit të mësimdhënësve tanë, besimit të prindërve, energjisë dhe talentit të nxënësve, si dhe mbështetjes së miqve tanë, organizatave partnere dhe shkollave gjermane me të cilat bashkëpunojmë.

Por rrugëtimi ynë nuk ndalet këtu. Synimi im si drejtor është që Loyola-Gymnasium të jetë gjithmonë një hap përpara, më inovative, më e sigurt dhe më e hapur ndaj bashkëpunimeve. Inovacioni në mësimdhënie, përdorimi i teknologjisë, krijimi i hapësirave të sigurta për nxënësit tanë, si dhe forcimi i partneriteteve me organizata, prindër dhe shkolla tjera gjermane, janë shtyllat mbi të cilat do të ndëtojmë të ardhmen.

Besoj fort se edukimi nuk është vetëm për të transmetuar dije, por për të formuar njerëz me vlera, që kontribuojnë për një shoqëri më të drejtë dhe më të përgjegjshme. Kjo është arsyeja pse çdo hap që ndërmarrim ka në qendër nxënësit.

Ju falënderoj nga zemra për besimin dhe mbështetjen tuaj gjatë këtyre viteve. Pa ju, kjo histori suksesi nuk do të ishte e mundur. Le të vazhdojmë së bashku, me të njëjtin përkushtim dhe energji, për ta bërë Loyola-Gymnasium një shembull të edukimit cilësor dhe inovativ në Kosovë, por jo vetëm.

Me respekt dhe përshëndetje të përzemërta,

Blerand Koshi
Drejtore i “Loyola-Gymnasium”



M. Lindita Spaqi

Drejtoreshë e “Loyola-Fillore”

Të dashur lexues, nxënës, ish-nxënës, prindër, mësimdhënës, bashkëpunëtorë, mbështetës e miq të shkollës sonë fillore Loyola dhe të familjes së madhe të ALG-së,

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time që në fillim për arritjet tona deri më tani. Shkolla fillore, që nga themelimi i saj në vitin 2013, është pritur me padurim dhe dashuri dhe është rritur vazhdimisht deri më sot, si në cilësi ashtu edhe në numër. Ajo është bërë një shtëpi e dytë e zhvillimit dhe rritjes në dije e vlera për shumë fëmijë, si dhe një adresë sigurie dhe cilësie për shumë prindër.

Shkolla fillore vazhdon të ruajë dhe të punojë fort në mbajtjen e një institucioni që ofron dashuri, siguri dhe cilësi mësimore për afërsisht 500 fëmijë, duke investuar çdo ditë në zhvillimin e secilit për t'iu përshtatur nevojave të kohës dhe brezave të rinj.

Si çdo vit tjetër, edhe në këtë vit shkollor na ka udhëhequr një objektivi i përbashkët – tematika e vitit. Për vitin 2024–2025, tematika ishte „Njohja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe e vlerave kombëtare“. Duke u mbështetur në këtë temë, mësimet e përditshme, festimet, iniciativat, vizitat dhe projektet e vitit u fokusuan në ndërgjegjësimin e fëmijëve për vlerat kombëtare.

Përkundër sfidave të kohës në arsim, sfidës së teknologjisë që po merr gjithnjë e më shumë vëmendje, uljes së vlerësimit për arsimin dhe rënies së figurës së mësuesit – sfida me të cilat përballet sistemi arsimor në mbarë botën – me siguri të plotë mund të them se ne po vazhdojmë t'i ruajmë vlerat që ofron shkolla jonë. Ne i ofrojmë secilit fëmijë që bëhet pjesë e familjes sonë të madhe një ambient të sigurt e të pastër, cilësi dhe mbështetje, argëtim dhe zhvillim social, zhvillim të mendimit të lirë dhe të kreativitetit. Njëkohësisht, ruajmë respektin për shkollën, detyrat që ajo ka, autoritetin e mësuesit dhe kufirin e secilit, aty ku fillon dhe mbaron e drejta dhe liria e tjetrit.

Jam shumë e lumtur dhe krenare që, si komunitet shkollor, po arrijmë të çojmë përpara një shkollë që tashmë ka krijuar emër dhe besimin e shumë familjeve. Me durim, urtësi, pa shumë zhurmë, por me qëndrueshmëri të palëkundur, kemi krijuar diçka të bukur dhe me shumë vlerë në qytetin tonë, për vendin tonë, duke i shtuar mozaikut të vlerave historike e kulturore që ka populli ynë.

Me mirënjohje për të gjithë – së bashku bëhen gjërat e mëdha, edhe kur duken të vogla.

M. Lindita Spaqi
Drejtoreshë e “Loyola-Fillore”



Bashkim Rrezja

Drejtor i “Loyola-Profesionale”

Sivjet “Loyola-Profesionale” ka hyrë në një fazë të re zhvillimi, duke shënuar jo vetëm vazhdimësinë e suksesit, por edhe rritjen e interesimit nga të rinjtë për drejtimin e Mekatronikës. Me fillimin e gjeneratës së katërt, numri i nxënësve është rritur dukshëm, gjë që tregon për besimin e shtuar që komuniteti dhe bizneset kanë tek modeli ynë arsimor profesional.

Në një treg pune që po ndryshon me shpejtësi për shkak të automatizimit, robotikës dhe teknologjive të avancuara industriale, “Loyola-Profesionale” vazhdon të përballet me sfida, por edhe me mundësi të reja. Zhvillimet e hovshme teknologjike në industrinë vendore dhe globale e bëjnë të domosdoshme që studentët tanë të aftësohen në mënyrë praktike dhe të jenë të gatshëm për kërkesat reale të punës.

Falë bashkëpunimit me një numër në rritje të bizneseve partnere – të cilave u jemi thellësisht falënderues – kemi arritur të përgatisim studentë që tashmë punojnë si operatorë robotësh industrialë dhe teknikë mekatronikë. Këto kompani po përfitojnë nga investimi i tyre në arsimimin e këtyre të rinjve, ndërsa studentët po tregojnë nivel të lartë profesionalizmi dhe përgjegjësie në punë.

Synimi ynë mbetet që këtë bashkëpunim ta zgjerojmë edhe më tej, duke përfshirë sektorë të rinj industrialë dhe duke krijuar një urë të qëndrueshme lidhëse midis arsimit profesional dhe tregut të punës.

Përveç angazhimit në industrinë lokale, “Loyola-Profesionale” mbetet aktive në projektet e brendshme të institucionit. Studentët marrin pjesë në rregullimin e pajisjeve teknike, krijimin e mini-projekteve, si dhe në projekte konstruktive dhe mekatronike brenda mjediseve të shkollës. Këto aktivitete nxisin kreativitetin, inovacionin dhe zgjidhjen praktike të problemeve.

Ndërkohë, shkolla është bërë një pikë referimi edhe për komunitetin arsimor dhe ekonomik. Gjatë vitit kemi pranuar vizita nga oda ekonomike, nga shkollat publike profesionale, si dhe nga nxënësit e “Loyola-Gymnasium” dhe “Loyola-Fillore”. Këto vizita forcojnë imazhin e shkollës; rrisin bashkëpunimin me komunitetin, dhe shërbejnë si mundësi prezantimi për programet tona profesionale.

Në tërësi, rritja e numrit të nxënësve dhe fillimi i gjeneratës së katërt dëshmon se modeli i edukimit profesional të “Loyola-Profesionale” është duke dhënë rezultate konkrete. Puna jonë për të përgatitur profesionistë të aftë, fleksibilë dhe teknologjikisht të përgatitur po ndikon drejtpërdrejt në krijimin e një fuqie punëtore moderne, të gatshme për sfidat e industrisë bashkëkohore.

Bashkim Rrezja
Drejtor i Loyola-Profesionale



Mirëseardhja e nxënësve të klasave të para në Loyola-Fillore

Një fillim që mbush zemra

Mëngjesi i 2 shtatorit 2024 solli gëzim dhe emocion në oborrin e shkollës, ku nxënësit e klasave të para, së bashku me prindërit e tyre, hodhën hapat e parë drejt botës së dijes. Në fjalën e hapjes, drejtoresha Motër Lindita Spaqi theksoi se fillimi i klasës së parë është një udhëtim i veçantë, ku çdo ditë sjell mundësi të reja për të zbuluar, për të mësuar dhe për t'u rritur. Ceremonia u mbyll me premtimin e përbashkët për ta bërë këtë vit një përvojë të bukur, të mbushur me miqësi dhe suksese.

Dita ime e parë si mësuese – një ëndërr që mori jetë

Mësuesja Hygerta Thaçi rrëfen emocionet e ditës së parë në rolin e mësueses së klasës së parë - një ditë që për të ishte më shumë sesa fillim profesional; ishte përmbushja e një ëndërr të gjatë. E rritur mes dy prindërve që jetën ia kushtuan arsimit, ajo e ndjeu këtë moment si një thirrje të brendshme, si një vazhdimësi të natyrshme të rrugës që kishte parë e admiruar që në fëmijëri.

Në klasën e saj të parë, midis syve kureshtarë të nxënësve dhe duarve të vogla që kërkonin siguri, çdo emocion u kthye në forcë dhe motivim. Ankthi i nisjes u shua sapo ajo pa buzëqeshjet e fëmijëve, që me besim e ndoqën drejt derës së shkollës - drejt një viti të mbushur me zbulime, punë, përkushtim dhe mbështetje të ndërsjellë.



Dita e Dyerve të Hapura në Loyola-Fillore – Një udhëtim i gjallë nëpër bukuritë, traditat dhe historinë e Kosovës

Artikull përmbledhës bazuar në shkrimet e mësimdhënësve nga Loyola – Fillore: mësuese Doruntina Rakaj, teacher Ilir Memaj dhe mësuese Judita Delhysa.

Më 5 tetor 2024, Shkolla Filllore “Loyola” hapi dyert për komunitetin me një festë plot ngjyra, muzikë dhe emocion – Ditën e Dyerve të Hapura, me temën “Eksplorojmë Kosovën”. Kjo ditë u shndërrua në një mozaik të bukur traditash, kujtimesh dhe përjetimesh që lidhën prindërit, nxënësit dhe mësimdhënësit në një histori të përbashkët dashurie për vendin.

Programi artistik në oborr shënoi fillimin e festës, ku muzika e Lorenc Antonit – “Malësorja” krijoi atmosferën e ngrohtë të një dite të veçantë. Këngët, vallet dhe dramat e interpretuara me entuziazëm treguan kreativitetin dhe shpirtin e fëmijëve, duke e mbushur oborrin me energji pozitive.



Në klasat e treta, traditat morën jetë përmes veshjeve tradicionale shqiptare, punimeve artistike dhe prezantimeve që tregonin historinë dhe simbolikën e tyre. Ndërthurja e ngjyrave, motiveve dhe elementeve popullore krijoi një ambient të mrekullueshëm, ku kultura jonë u shfaq me gjithë madhështinë e saj.

Galeria e klasave u kthye në një udhëtim të vërtetë eksplorimi.



Klasat e dyta prezantuan faunën e Kosovës, duke sjellë para vizitorëve larmishmërinë e zogjve vendas.


Klasat e treta riprodhuan momente nga jeta shqiptare në fshat në vitet '70, përmes fotografive dokumentare.

Klasat e katërta shpalosën traditat familjare, duke treguar zakonet dhe ritualet që ruajnë identitetin tonë kulturor.

Klasat e pesta përqendruan vëmendjen te bukuritë natyrore dhe filigrani prizrenas, duke treguar rëndësinë e artit dhe natyrës në formimin e identitetit kombëtar.

Prindër, nxënës dhe vizitorë lëviznin nga një klasë në tjetrën duke përjetuar punën, kreativitetin dhe përkushtimin e fëmijëve. Dita u karakterizua nga bashkëpunimi, gëzimi dhe një ndjenjë e fortë komuniteti.

Në fund të ditës, në çdo buzëqeshje shihej krenaria. Në çdo klasë ndjehej përkujdesja. Në çdo detaj – duart që punuan, zemrat që u angazhuan, fëmijët që shkëlqyen.



Kujtime dhe mësim

Ditët tematike që ndriçuan vitin shkollor në Loyola Fillore

Gjatë këtij viti shkollor, korridoret dhe klasat e Loyola Fillore u mbushën me ditë të shënuara që sollën gëzim, dije dhe përvoja që i bëjnë fëmijët të rriten jo vetëm në mendje, por edhe në shpirt.

Dita e Gjuhës Amtare ishte ndër momentet që la gjurmë. Në çdo klasë, fëmijët u ndalën të reflektonin mbi gjuhën shqipe – rrënjët e identitetit tonë. Me poezi, shkrime dhe biseda të ngrohta, ata kuptuan se ruajtja e gjuhës është një dhuratë që i jepet brez pas brezi.

Dita Ndërkombëtare e Ujit solli një javë të tërë aktiviteteve sensibilizuese. Nxënësit e klasave të dyta dhe të katërta u angazhuan me zemër, duke krijuar punime, prezantime dhe mesazhe që kujtonin se çdo pikë uji është jetë. Ishte një thirrje e sqartë për kujdes, kursim dhe përgjegjësi.



Dashuria për librin mori skenën gjatë **Ditës Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë**. Interpretimet poetike, skeçet dhe pikat muzikore e kthyen shkollën në një festë të letrave, duke i sjellë fëmijët edhe më afër botës magjike të leximit.

Edhe natyra pati ditën e saj të madhe me kremtimin e **Ditës së Tokës**. Fëmijët mësuam për mbrojtjen e planetit dhe, mes ngjyrave e luleve të reja të mbjella në oborr, kuptuan se dashuria për tokën nis nga veprimet e vogla.

Mjedisit iu kushtuan edhe dy ditë të tjera domethënëse: **Dita e Shpendëve dhe Dita Botërore e Bletëve**. Me fole të vogla, punime artistike dhe mësim mbi rolin jetik të këtyre krijesave, nxënësit zbuluan se natyra është një ekosistem i brishtë që ka nevojë për vëmendjen e tyre.

Një tjetër përvojë e vlefshme ishte **vizita në Muzeun e Shpendëve të Ngrirë**, ku fëmijët u njohën nga afër me biodiversitetin e Kosovës dhe me punën e studiuesve që ruajnë speciet tona.

Viti përfundoi me tingujt e gëzuar të **Ditës Ndërkombëtare të Muzikës**. Bluza të pikturuara nga vetë nxënësit, këngë, instrumente dhe një atmosferë që i kishte rrënjët te gëzimi i pastër fëmijëror – edhe pse moti ndryshoi planet, buzëqeshjet ngelën të pandryshuara.

Kështu, çdo ditë e shënuar u bë një mësim i jetës: për vlerat, përgjegjësinë, kreativitetin dhe dashurinë për botën që na rrethon. Një vit i pasur me përvoja që ushqejnë mendjen dhe zemrën.





Festa e Abetares Mbretëria e Shkronjave

Më 16 maj 2025, kampusi i Loyola Fillore u mbush me gëzim dhe ngjyra gjatë Festës së Abetares, ku 105 nxënës të klasave të para festuan përfundimin e udhëtimit të tyre të parë në botën e shkronjave. Fëmijët sollën në skenë një program të mbushur me këngë, vallëzime dhe interpretime të singerta, duke krijuar një atmosferë të paharrueshme për prindërit dhe të ftuarit.

Kjo ditë është rezultat i punës së përbashkët midis fëmijëve, mësimeve dhe prindërve. Me përkushtim dhe profesionalizëm, mësuesit udhëhoqën fëmijët në “mbretërinë e shkronjave”, duke i ndihmuar të zbulojnë tingujt dhe gëzimin e leximit.

Motër Lindita Spaqi, që udhëhoqi festën, theksoi se çdo buzëqeshje e fëmijëve tregon punën e palodhur të bërë çdo ditë në klasë. Në përfundim, ajo që mbeti nuk ishte vetëm programi artistik, por drita në sytë e fëmijëve – drita e një rruge të bukur që sapo ka nisur.



Java e Sportit në Loyola-Fillore

Lëvizje, energji dhe bashkim

“Në një atmosferë plot gjallëri e entuziazëm, shkolla jonë festoi “Javën e Sportit” – një iniciativë që i ftoi nxënësit të lëvizin, të garojnë me ndershmëri dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin” – thotë mësimitdhënësi i Edukatës Fizike Valon Bajraktari. Çdo ditë solli lojëra verore, sfida të reja dhe shumë buzëqeshje, duke e shndërruar oborrin e shkollës në një arenë të vërtetë energjie.

Nxënësit morën pjesë me dëshirë dhe përkushtim, duke treguar shpirtin e një komuniteti që e vlerëson sportin jo vetëm si aktivitet fizik, por si një mënyrë për të mësuar respektin, pranimin dhe frymën e ekipit. Lojërat, garat dhe momentet e gëzimit ndërthuren me ndjenjën e solidaritetit që sporti arrin ta sjellë natyrshëm tek fëmijët.

Falë angazhimit të mësimitdhënësve të edukatës fizike, Java e Sportit u zhvillua në një ambient motivues dhe të barabartë për të gjithë.

Kjo javë u bë rikujtim i bukur se sa e rëndësishme është lëvizja për trupin dhe mendjen, dhe se shkolla është vendi ku miqësia dhe sportiviteti rriten krah për krah. Java e Sportit tashmë ka zënë vend si një traditë që synon të rrisë një gjeneratë aktive, të shëndetshme dhe të motivuar – një traditë që do të vazhdojë të sjellë gëzim në vitet që vijnë.



Një javë frymëzimi: Miss World England dhe Festa e Gjuhës Angleze në Loyola Fillore

Kjo javë në Loyola Fillore solli dy ngjarje të veçanta që i dhanë shkollës energji, kreativitet dhe frymëzim. Vizita e Miss World England, znj. Mila Magee, u bë një takim i paharrueshëm për nxënësit. Në kuadër të fushatës “Go Far with CPR”, ajo foli me fëmijët për guximin, përgjegjësinë dhe ndihmën ndaj tjetrit, duke iu përgjigjur me ngrohtësi pyetjeve të tyre. Teacher Drita Morina theksoi se kjo vizitë i inkurajoi nxënësit të besojnë më shumë në veten e tyre.

Në të njëjtën javë, u festua edhe Gjuha Angleze me aktivitete të shumëllojshme. Klasat e para sollën “Show and Tell” në oborr, ndërsa klasat e dyta e mbushën sallën me ngjyra në “Vocabulary Parade”. Nxënësit e klasave të treta punuan me projektin “The Tale of Peter Rabbit”, duke lexuar, analizuar dhe krijuar punime që u prezantuan në një ekspozitë të vogël. Klasat e katërta hulumtuan autorë anglezë për fëmijë dhe i prezantuan me vetëbesim rezultatet e tyre.

Ndërkohë, klasat e pesta pritën tre ish-nxënës të suksesshëm të Loyola Fillore – Tone Kqira, Yllza Gorani dhe Ed Aliaj – të cilët, në kuadër të projektit “Role Models”, treguan historitë e tyre motivuese dhe i frymëzuan nxënësit që të jetësojnë ëndrrat e tyre.

Me bashkëpunimin e Teacher Ilir Memaj dhe Teacher Drita Morina, kjo javë u shndërrua në një përvojë ku nxënësit mësuuan, krijuan dhe u frymëzuan – ashtu siç duhet të jetë çdo ditë në shkollë.



Loyola dhe libri: Dy klube, një frymë e përbashkët

Këtë vit, në të dy kampuset – Loyola-Cymnasium dhe Loyola Fillore – u themeluan dy iniciativa që e vendosin librin në qendër të jetës shkollore: Klubi i Librit në gjimnaz dhe Klubi i Leximit në fillore. Të ndryshëm në moshë, por të bashkuar në qëllim.

Në gjimnaz, më 30 prill 2025 u themelua klubi “Kapitel und Kaffee”, i udhëhequr nga mësimmshënësja e gjuhës gjermane Shpres Zeka Karanezi. Dhjetë nxënës nga klasat e 10-ta dhe 11-ta krijuan një komunitet të vogël letrar me takime mujore, diskutime të hapura dhe zgjedhje të përbashkëta librash. Libri i parë — “Mord im Orientexpress” i Agatha Christie — u kthye në pikënisjen e një tradite të re që synon të zhvillojë mendimin kritik dhe dashurinë për letërsinë.

Në anën tjetër, në Loyola Fillore, siç tregon mësuesja Merita Zeqiri, fëmijët ngritën një klub leximi plot energji dhe kureshtje. Ata lexuan, hulumtuan, punuan në grupe dhe organizuan një festë për Ditën Botërore të Librit. Përkushtimi i tyre u vlerësua me një dhuratë simbolike, në shenjë mirënjohjeje për angazhimin e treguar.

Dy klube, një qëllim i përbashkët: të sjellin më shumë lexime, më shumë biseda dhe më shumë botë të reja në jetën e nxënësve tanë.



Festat e fundvitit në ALG

Një magji e përbashkët në Fillore, Gjimnaz dhe Konvikt

Në Loyola Fillore, fundviti solli ditë plot dritë, kreativitet dhe gëzim. Koncertet festive të fëmijëve u shndërruan në momente të paharrueshme, ku nxënësit ndanë talentin dhe emocionet e tyre me prindërit. Vizita falënderuese për kuzhinierët, krijimi i kartolinave për gjyshërit dhe atmosfera e ngrohtë në ditën e fundit të shkollës e bënë këtë periudhë të veçantë një festë të vërtetë mirësie e bashkësie.



Në Loyola-Gymnasium, mbrëmja festive u mbush me muzikë, këngë dhe interpretime artistike, duke sjellë magjinë e Krishtlindjes dhe shpresën e Vitit të Ri. Atmosfera e krijuar nga nxënësit ishte një ftesë për gëzim, reflektim dhe mirësjellje. Përveç koncertit, gjatë kësaj periudhe u organizuan edhe gara letrare e poetike, ku nxënësit sollën krijimet e tyre origjinale, duke e pasuruar programin me art e kreativitet të rinjsh.



Në Konviktin e Gjimnazit Loyola, festat morën një dimension të dyfishtë — artistik dhe humanitar. Programi festiv i organizuar nga nxënësit magjepsi të pranishmit me këngë, muzikë dhe performanca kulturore. Në të njëjtën kohë, nxënësit vizituan qendrën burimore “Nënë Tereza”, ku dhuruan dhurata për fëmijët shurdh-memecë, duke përcjellë mesazhin e dhembshurisë dhe solidaritetit. Konvikti mbetet një shtyllë unike brenda ALG-së, duke ofruar një mjedis të sigurt dhe mundësi të pasura zhvillimi për nxënësit nga gjithë trevat.



Një ëndërr që rreh prej 20 vitesh

Historia e Loyola-Gymnasium, e shkruar me zemër

Ka momente kur koha duket sikur ndalet për të na kujtuar se sa larg kemi ardhur. Dita e 20-vjetorit të Loyola-Gymnasium ishte pikërisht një nga ato ditë. Një ditë kur shkolla nuk ishte thjesht hapësirë mësimi — por një album kujtimesh, një skenë emocionesh, një tregim i gjallë i një udhëtimi që vazhdon të shkruhet me dashuri, përkushtim dhe vizion.



Fillimi: 16 prill 2005 – Kur një gur themeli u bë premtim

Aty nisi gjithçka. Një gur themeli u vendos në tokën e Prizrenit, por më shumë se kaq: u vendos në zemrat e njerëzve që besuan në një projekt që dukej më shumë se ambicioz — dukej i pamundur. Por aty qëndron magjia e çdo fillimi të madh: fillon me ëndërr, me guxim dhe me besimin se drita e arsimit mund të ndryshojë jetë.

Në këto 20 vite, ajo ëndërr jo vetëm që u bë realitet, por u bë shtëpi për mijëra nxënës, vend ku u rritën breza, u forcuan karaktere, u ushqyen talente dhe u ndërtuan histori suksesi.

Shkolla si komunitet – Dita kur çdo klasë u bë skenë

Në Ditën e Dyerve të Hapura, çdo klasë ishte një univers më vete.

Mësimdhënësit dhe nxënësit krijuan aktivitete që tregonin jo vetëm kreativitetin, por edhe identitetin e kësaj shkolle:

- **Ora të hapura mësimore**, ku prindërit panë nga afër si mësojnë fëmijët e tyre: me pasion, me bashkëpunim dhe me respekt.
- **Ekspozita artistike**, ku murale, dizajne grafike, punime 3D dhe instalacione u shndërruan në galeri të vogla arti.
- **Demonstrime të eksperimenteve shkencore**, ku shkëndijat e kimisë dhe fizikës nuk ishin vetëm reaksione — ishin dëshmi e kuriozitetit dhe inteligjencës së nxënësve tanë.
- **Këndet gjuhësore**, ku u recituan poezi në anglisht, gjermanisht, shqip dhe latinisht — sepse Loyola është gjithmonë shkollë e shumë gjuhëve, kulturave dhe identiteteve.
- **Performanca muzikore**, nga kuartetet instrumentale e deri tek zërat e korit të nxënësve.



Kudo, në çdo hap, në çdo klasë, ndihej një energji e veçantë — energjia e një shkolle që ka 20 vjet që rrit fëmijët jo vetëm intelektualisht, por edhe shpirtërisht.

Korridoret që ruajnë kujtimet e mijëra hapave

Në ditën e përvjetorit, nuk ishte vetëm në një shkollë — ishte në një histori të gjallë.

Ish-nxënësit ecën sërish nëpër korridoret e dikurshme, me një përzierje emocionesh: nostalgji, mirënjohje, buzëqeshje të buta që shprehin të pathënën —

“Sa shumë më ndryshoi kjo shkollë.”



Prindër, miq, partnerë, bashkëpunëtorë... të gjithë u bënë bashkë. Po atë ditë, dy prej njerëzve që e nisën këtë rrugëtim që nga viti i parë i themelimit, u nderuan mes duartrokitjeve të merituar: prof. Mentor Ukimeri, mësimdhënës i Edukatës Fizike, dhe znj. Hamide Elshani, drejtoreshë e Administratës dhe Financave.

Dhe në atë ditë u kuptua qartë se suksesi i Loyola-s nuk qëndron vetëm tek infrastruktura moderne apo programet e pasura mësimore — por tek komuniteti i saj: një bashkësi që ka 20 vjet që mban gjallë një ëndërr të përbashkët.

Shpirti i Loyola-s – dija me zemër

Ka shkolla që ofrojnë dijen.



Ka shkolla që ofrojnë mundësi.

Por ato që i japin fëmijës dritë në shpirt, forcë në karakter dhe sens të përgjegjësisë — janë të rralla.

Loyola-Gymnasium ka ndërtuar një identitet të vetin: dija me shpirt.

Këtu mësohet matematika, por edhe ndershmëria.

Mësohet fizika, por edhe respekti.

Mësohet letërsia, por edhe empatia.

Mësohen gjuhët e huaja, por edhe gjuha e mirësisë.

Kjo është madhështia e kësaj shkolle: ajo nuk formon vetëm nxënës të mirë — formon njerëz të mirë.



20 vjet pas – historia vazhdon

Në mbrëmjen e 20-vjetorit, shkolla rrezatonte si asnjëherë më parë:

muzikë, fjalime, përqaftime, duartrokitje, histori të rrëfyera, foto të vjetra, ëndrra të reja...

Ishte një ditë e bukur, një ditë që do të ruhet përherë si një prej momenteve më domethënëse në historinë e Loyola-s.



Dhe ndërsa buzëqeshjet e fundit të asaj dite u fikën, mbeti diçka e qartë:

**Loyola-Gymnasium nuk është një ndërtesë.
Nuk është vetëm shkollë.**

Është një ëndërr që rreh prej 20 vitesh — një ëndërr që mbetet e gjallë në çdo zemër që ka kaluar pragun e saj, në çdo mësues që mëson me pasion, në çdo nxënës që guxon të ëndërrojë dhe në çdo prind që i beson kësaj shtëpie të madhe arsimore.

20 vjet janë vetëm fillimi.

Pjesa më e bukur e historisë — ajo që do të vijë — ende po shkruhet.

Matura BBQ Party

Nata që mbetet përjetë

Në kampusin e Loyola-Gymnasium, maturantët e vitit 2025 jetuan një natë që nuk harrohet lehtë. Matura BBQ Party, tashmë traditë e dashur, u rikthye për të dytin vit radhazi duke sjellë me vete atmosferë gëzimi, miqësie dhe emocione të singërta.

Në një mbrëmje të ngrohtë pranvere, nxënësit përgatitën vetë ushqimet në zgarë, qeshën, kënduan dhe ndanë momente që pasqyronin miqësinë e krijuar ndër vite. Aktiviteti “Një porosi për ty” u shndërrua në një nga pjesët më prekëse: letra, falënderime, kujtime të vogla që shpesh nuk thuhën, por që atë natë u shkruan me zemër.

Ndezja e zjarrit krijoi një rreth simbolik bashkimi, ndërsa muzika dhe vallëzimi rreth tij, i dhanë mbrëmjes dritën e vet. Kulmi i natës ishte ndezja e fenereve që u ngritën mbi kampus, duke e mbushur qiellin me dëshira dhe ëndrra të maturantëve.

Për ta bërë gjithçka edhe më të veçantë, nxënësit kaluan natën në konvikt dhe në ambientet e shkollës, duke e mbyllur mbrëmjen si një familje që po i thotë lamtumirë një kapitulli të bukur.

Një natë, shumë kujtime.

Loyola-Gymnasium – aty ku festat bëhen histori



Diplomimi 2024–2025: Një mbrëmje gëzimi, mirënjohjeje dhe fillimesh të reja në Loyola

Në Loyola, diplomimi nuk është vetëm një ceremoni – është një festë e rritjes, përkushtimit dhe ëndrrave që nisin fluturimin. Këtë vit, gjenerata 2024–2025 u nderua me dy aktivitete të veçanta që u zhvilluan në harmoni mes Loyola–Konvikt dhe Loyola–Gymnasium, duke krijuar një atmosferë të paharrueshme për maurantët tanë.

Në konvikt, tradita e festës së përvitshme përshëndetëse solli ritëm, emocion dhe shumë kujtime. Nxënësit, të rrethuar nga shokët, edukatorët dhe personeli, ndanë momente reflektimi e mirënjohjeje për vitet e kaluara së bashku. Muzika, urimet dhe buzëqeshjet krijuan një ambient familjar, ku çdo maurant u ndje pjesë e një komuniteti që i ka qëndruar pranë në çdo hap të rrugës.

Ndërkohë, në Loyola–Gymnasium u zhvillua ceremonia zyrtare e diplomimit – tashmë për të dytin vit me radhë në formë festive. I ftuari i mbrëmjes, prof. Besnik Krasniqi, mbajti një fjalë frymëzuese mbi guximin, punën e ndershme dhe rolin e të rinjve në një shoqëri që ndryshon vazhdimisht.

Gjatë mbrëmjes u ndanë çmimet tradicionale për nxënësit e dalluar në aspektin akademik dhe për sjellje shembullore – një vlerësim i merituar për përkushtimin e tyre shumëvjeçar.

Diplomimi 2024–2025 në Loyola ishte më shumë se një mbyllje viti; ishte një fillim i ri, i mbushur me shpresë dhe besim se këta të rinj do të ecin përpara me vlera, dije dhe zemër të madhe.



Jeta në Loyola–Konvikt

Shtëpia e dytë ku rriten miqësia, kreativiteti dhe vetëbesimi

Loyola–Konvikt është shumë më tepër se një ambient banimi për nxënësit – është një komunitet i gjallë, i ngrohtë dhe plot aktivitete që e pasurojnë çdo ditë të tyre. Jeta këtu ndërthuret mes studimit, argëtimit dhe zhvillimit personal, duke krijuar një atmosferë ku fëmijët rriten të sigurt, të përgjegjshëm dhe kreativë.

Çdo javë, konvikti gjallërohet me aktivitete të shumëllojshme: përgatitja e ëmbëlsirave, e cila i bashkon nxënësit rreth aromave të bukura dhe bashkëpunimit; sesionet e yoga-s, që i ndihmojnë të gjejnë qetësi, ekuilibër dhe fokus; si dhe aktivitetet sportive që forcojnë trupin, disiplinën dhe frymën ekipore.

Kreativiteti zë vend të veçantë në jetën e konviktit. Fëmijët marrin pjesë në punë dore, krijojnë dekorime, pikturojnë dhe shprehin imagjinatën e tyre përmes artit. Po ashtu, aktivitetet artistike si këndimi, vallëzimi dhe aktrimi u japin atyre hapësirë të shpërthejnë talentet dhe të ndihen pjesë e një skene që i mirëpret me duartrokitje.

Falë përkushtimit të edukatorëve dhe stafit, Loyola–Konvikt mbetet një vend ku çdo nxënës gjen mbështetje, frymëzim dhe një shtëpi të dytë. Këtu, çdo ditë është një mundësi për të mësuar, për të qeshur dhe për të ndërtuar kujtime që mbeten gjatë.



Inovacion dhe qëndrueshmëri Loyola-Profesionale në projektin TtraSE

Gjatë këtij viti, Loyola-Profesionale mori pjesë aktive në projektin ndërkombëtar TtraSE – “Twin Transition for Social Enterprises in Arts and Craft Sectors”, të mbështetur nga BE dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Projekti synon të fuqizojë ndërmarrjet sociale dhe artizanatin përmes tranzicionit dixhital dhe atij të gjelbër.

Si pjesë e Arsimit dhe Formimit Profesional në Kosovë, shkollajonë kontribuoi përmes trajnimeve, punëtorive dhe shkëmbimeve profesionale, duke u bërë pjesë e një rrjeti të gjerë bashkëpunimi.

Pjesëmarrja e Loyola-Profesionale në TtraSE ka sjellë dy përfitime kryesore:

- Forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit dhe instruktorëve;
- Zgjerimin e bashkëpunimit me organizata vendore dhe ndërkombëtare.

Ky angazhim e vendos shkollën tonë në hap me zhvillimet moderne të AFP-së dhe përforcon rolin e saj në ndërtimin e një arsimit profesional më inovativ dhe të qëndrueshëm.



Kurse afatshkurtra në Loyola-Profesionale

Loyola-Profesionale ofron kurse afatshkurtra praktike për të rinjtë dhe profesionistët që dëshirojnë të zhvillojnë aftësi teknike të kërkuara në tregun e punës. Trajnimet udhëhiqen nga instruktorë të specializuar dhe kombinojnë teori të nevojshme me punë praktike në laboratorë të pajisur bashkëkohorë.

Kurset e ofruara përfshijnë:

- PLC (Logjikë Programueshme) – bazat e automatizimit industrial;
- Pneumatikë dhe Hidraulikë Industriale – funksionimi dhe aplikimi i sistemeve teknike;
- Bazat e Elektroteknikës – konceptet kryesore elektrike për fillestarë;
- Mekanika Teknikë / Mekanikë e Përgjithshme – njohuri bazë për punime mekanike dhe mirëmbajtje.

Këto programe synojnë të pajisin pjesëmarrësit me kompetenca konkrete dhe praktike, duke krijuar mundësi më të mëdha punësimi dhe orientimi profesional. Loyola-Profesionale mbetet një vend i rëndësishëm për arsimim teknik cilësor dhe aftësim profesional të shpejtë.



Diplomimi i gjeneratës së dytë në Mekatronikë

Në qershor 2025, Loyola-Profesionale shënoi një moment të veçantë: diplomimin e gjeneratës së dytë në drejtimin Mekatronikë – Operatorë të Robotëve Industrialë. Ky grup i ri të diplomuarish u përgatit përmes një programi praktik e modern, i cili kombinon mekanikën, elektroteknikën dhe programimin e robotëve.

Gjatë dy viteve të studimit, nxënësit punuan në laboratorët e pajisur me teknologji bashkëkohore, duke fituar aftësi që i përgatisin për tregun e punës dhe industrinë moderne. Instruktorët e Loyola-Profesionale i kanë udhëhequr në çdo hap, duke i pajisur me kompetenca profesionale dhe etikë pune.

Ky diplomim përfaqëson një sukses të rëndësishëm për institucionin dhe një hap të madh për të rinjtë që synojnë karrierë në industrinë teknike dhe automatizim. Gjenerata e dytë dëshmon se arsimi profesional cilësor po jep rezultate konkrete dhe po ndërton profesionistët e së ardhmes.





Mësimi përtej klasës

Përvoja që rrisin fëmijët tanë

Në ALC, besojmë se mësimi i vërtetë ndodh kudo: në muze, në institucione, në natyrë, në rrugët e qytetit. Këtë frymë e përmbloodhi mrekullisht seria e vizitave edukative të zhvilluara gjatë vitit, të cilat – siç thekson Motër Lindita Spaqi – i ndihmojnë fëmijët “të shohin më shumë, të kuptojnë më thellë dhe të rriten si qytetarë të vetëdijshëm”.

Nxënësit e klasave të katërta udhëtuan drejt Muzeut Etnografik në Gjakovë, ku u njohën me veshjet tradicionale, objektet e vjetra dhe mënyrën e jetesës së dikurshme. Çdo artefakt u bë një dritare e vogël drejt historisë sonë kulturore.



Klasat e treta vizituan Stacionin Policor ALFA në Prizren. Aty fëmijët panë nga afër punën e policëve dhe dëgjuan me vëmendje komandantin Nexhdet Mrasori, duke kuptuar sa i rëndësishëm është roli i policisë në mbarëvajtjen e komunitetit.



Për nder të Pavarësisë së Kosovës, nxënësit e klasave të pesta patën një ditë të mbushur me përvoja: vizituan Kuvendin e Kosovës, u takuan me pjesëtarë të FSK-së në Kazermën “Adem Jashari” dhe morën pjesë në aktivitete edukative në shkollën “Don Bosco”. Një udhëtim që ndërthurte edukimin qytetar me festën dhe gëzimin.

Një tjetër përvojë e rëndësishme ishte vizita në Kompleksin Memorial të Prekazit – një mësim i fuqishëm mbi historinë dhe sakrificën. Dita u përmbyll me një ecje të bukur drejt Burimit të Drinit të Bardhë, ku fëmijët e bashkuan refleksionin me bukuritë e natyrës.

Këto momente – nga muzetë të institucionet dhe te natyra – i rikujtojnë fëmijëve se bota është klasa e tyre më e madhe. E çdo përvojë u ndihmon të rriten jo vetëm në dije, por edhe në zemër.



Udhëtimet e Loyola Fillore që mësojnë, gëzojnë dhe lidhin fëmijët me natyrën

Gjatë këtij viti shkollor, nxënësit e Loyola Fillore përjetuan disa udhëtime të paharrueshme, ku mësimi u zhvendos nga klasa në natyrë—atje ku çdo hap bëhet zbulim dhe çdo përvojë mbetet kujtim.

Klasat e para vizituan fermën “Lazdrohu n’Fermë”, ku fëmijët u afruan me botën e kafshëve shtëpiake. Ata ushqyen, përkëdhelën dhe mësuan si të kujdesen për to, duke kaluar një ditë plot lojëra, të qeshura dhe dashuri për natyrën. Ishte përvoja e tyre e parë kaq pranë blegtorisë - e thjeshtë, e ngrohtë, por thellësisht edukative.

Ndërkohë, klasat e treta udhëtuan drejt **Pyllit të Arinjve**, një vend që u mësoi fëmijëve për kujdesin, mbrojtjen e kafshëve dhe respektin për biodiversitetin. Takimi me arinjtë e shpëtuar dhe ecja nëpër pyll i bëri fëmijët të reflektojnë mbi natyrën dhe jetët që ndodhen nën kujdes të përditshëm.



Përralla vazhdoi për klasat e katërta dhe të pesta në “**Kasollat e Zanave**”, një hapësirë magjike ku fëmijët eksploruan, luajtën dhe bashkëpunuan si një komunitet i vogël i gëzueshëm. Ambienti i gjelbër, këndet e lojërave dhe takimi me kafshët krijuan një ditë që dukej sikur vinte nga një histori fëmijësh.

Një vit i tillë mbetet dhuratë: plot emocione, zbulime dhe kujtime që i shoqërojnë fëmijët gjatë rrugës së tyre drejt rritjes.



Në Krushë të Madhe dhe Rahovec: një ditë mësimi, reflektimi dhe përjetimesh të reja

Në kuadër të temës “Eksplorojmë Kosovën”, nxënësit e klasave të dyta zhvilluan një vizitë emocionuese dhe plot mësim në Kooperativën bujqësore “Krusha”, në Krushë të Madhe. Në këtë vend të mbushur me histori dhe dhimbje, fëmijët u njohën me rrëfimin prekës të znj. Fahrije Hoti, e cila ndau me ta sfidat, sakrificat dhe forcën që e çoi drejt themelimit të kësaj punëtorie. Edhe pse të vegjël, nxënësit e ndjenë peshën e historisë dhe kuptuan se sa e vështirë është të rritesh pa një prind.

Mikpritja e ngrohtë e zonjave që punojnë në kooperativë e bëri vizitën edhe më të paharrueshme. Ato i prezantuan fëmijët me proceset e punës, u përgjigjën me dashuri pyetjeve të tyre të shumta dhe i përcollën me dhurata simbolike — një gjest që la gjurmë të bukura në zemrat e nxënësve.

Udhëtimi vazhdoi drejt Rahovecit, në verarinë “Bodrumi i Vjetër”, ku fëmijët u mahnitën nga fuqitë gjigante, makineritë dhe procesi i prodhimit të verës. Edhe pse të vegjël, ata dëgjuan me kujdes shpjegimet dhe morën këshilla të rëndësishme për përdorimin e përgjegjshëm të produkteve të rrushit. Vizita u shndërrua në një kombinim të bukur të njohjes kulturore, historisë lokale dhe eksplorimit.

Siç e thekson edhe mësuesja Shukrije Besimi, kjo ditë i mësoi fëmijët jo vetëm për vendet që vizituan, por edhe për humanitetin, qëndrueshmërinë dhe vlerat e bashkësisë — mësimet që mbeten përtej çdo ore mësimore në klasë.



Magjia e skenës dhe ekranit

Përvoja që ushqejnë imagjinatën

Këtë vit, nxënësit e klasave të dyta të Loyola Fillore përjetuan dy aktivitete të veçanta që u hapën derën botëve të reja — një vizitë në teatër dhe një ditë kinoje — duke sjellë gëzim, reflektim dhe shumë imagjinatë.

Vizita në Teatrin e Qytetit “Bekim Fehmiu” ishte një aventurë e paharrueshme. Fëmijët u zhytën në botën e dritave, kostumeve dhe personazheve magjike gjatë shfaqjes “Pula pispilluqe me çizme të kuqe”. Ata ndoqën me përqendrim çdo skenë, qeshën me zemër të hapur dhe panë se si teatri sjell në jetë histori që frymëzojnë. Përvoja i ndihmoi të kuptojnë se arti skenik nuk argëton vetëm, por zgjon empati, rrit ndjeshmërinë dhe nxit dëshirën për të ëndërruar më shumë.

Po kaq e bukur ishte edhe dita e kinemasë, ku nxënësit shikuan filmin “Dog Man”. Përveç argëtimit, filmi u përcolli vlera të rëndësishme si guximi, ndershmëria dhe miqësia — mesazhe të thjeshta, por jetike për zhvillimin e tyre emocional dhe social.

Siç nënvizojnë mësueset Katarina Gojani dhe Arijeta Ukaj, këto aktivitete janë shumë më tepër se një dalje jashtë klase: ato janë momente ku fëmijët rriten në kreativitet, shprehin botën e tyre të brendshme dhe zbulojnë bukurinë e artit.

Teatri dhe filmi u bënë kështu dy dritare të hapura që i ndihmuan t’i shohin emocionet, historitë dhe idetë me një sy më të gjerë e më të ndjeshëm.



Një vizitë që preku zemrat Loyola-Gymnasium në Down Syndrome Prizren

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Down, nxënësit e klasave të gjashta të Loyola-Gymnasium zhvilluan një vizitë të ngrohtë dhe plot emocione në Qendrën Down Syndrome Prizren.

Nën përkujdesjen e mësimeve të Loyola – Gymnasium prof. Nora Hoxha dhe prof. Ylberina Susuri, përmes aktiviteteve psiko-sociale, lojërave dhe bisedave të singërta, u krijuan momente që nuk do të harrohen lehtë.

Të qeshurat, përqafimet dhe bashkëpunimi i ndërsjellë krijuan një atmosferë ku ndjeshmëria, empatia dhe dashuria pa kushte u bënë udhërrëfyes.

Për nxënësit tanë, kjo vizitë ishte një mësim i vërtetë jete: për rëndësinë e përfshirjes, pranimt të diversitetit dhe vlerës së secilit individ.

Faleminderit Qendrës Down Syndrome Prizren për mikpritjen dhe për mundësinë që u dha fëmijëve tanë të përjetojnë një ditë kaq të veçantë.

Një ditë e thjeshtë, një mësim i madh.



Në gjurmët e ujit

Një mësim i gjallë për jetën dhe përgjegjësinë

Nxënësit e klasave të 8-ta të Loyola-Gymnasium përjetuan një ditë mësimore ndryshe — një udhëtim që i çoi përtej teorisë së librave, drejt zemrës së një procesi thelbësor për jetën: trajtimin të ujërave të ndotura.

Të shoqëruar nga mësimdhënëset prof. Leonora Nua, prof. Yllza Kolloni, prof. Ermira Mazreku dhe prof. Shëga Memaj, ata vizituan Impiantin e Trajtimin të Ujrave të Ndotura në Vlashnjë, duke parë nga afër rrugëtimin që bën uji për t'u pastruar dhe për t'iu kthyer natyrës.

Në çdo hap të vizitës, nxënësit kuptuan se uji nuk është thjesht H_2O — është një cikël i tërë që lidhet me kiminë, fizikën dhe biologjinë, dhe mbi të gjitha, me jetën tonë të përditshme. Për ta, ky udhëtim u kthye në një laborator të hapur ku mjedisi flet vetë, ku teknologjia shfaqet në shërbim të natyrës dhe ku çdo pikë uji ka vlerë të pazëvendësueshme.

Uji është jetë — dhe jeta kërkon kujdes.
Le ta mbrojmë me dije, vullnet dhe dashuri.



Loyola-Gymnasium në Trepçë – një ditë që ndriçoi dijen

Nxënësit e tri klasave të njëmbëdhjeta përjetuan një ditë të veçantë mësimi në Muzeun e Mineraleve Trepçë – Mitrovicë, ku shkenca mori formë konkrete dhe kureshtja u kthye në udhërrëfyes.

Në këtë vizitë, ata u njohën me botën magjepsëse të mineraleve, prejardhjen e tyre, strukturat unike dhe rëndësinë që kanë në industri, teknologji, mjekësi dhe jetën e përditshme. Çdo vitrinë e muzeut, çdo mostër dhe shpjegimi profesional krijuan një mjedis të gjallë eksplorimi — një laborator i hapur që u foli nxënësve me gjuhën e shkencës.

Falë prof. Haxhere Faiku dhe prof. Gresa Shala, vizita u shndërrua në një përvojë të organizuar me kujdes dhe entuziazëm, duke lidhur teorinë me praktikën dhe duke i afuar nxënësit me shkencat natyrore në mënyrë inspiruese.



Një ditë skijimi për nder të Pavarësisë Liria që festohet me lëvizje

Në prag të Pavarësisë së Kosovës, nxënësit e Loyola-Gymnasium zgjedhën një mënyrë të veçantë për ta festuar këtë ditë të madhe: duke i dhënë vetes sfidë, frymë dhe gëzim nëpër shpatet e mbuluara me borë. Aktiviteti, i udhëhequr me profesionalizëm nga prof. Mentor Ukimeri, bashkoi sportin me simbolikën e kësaj feste – lirinë për të lëvizur, për të rritur veten dhe për të shijuar jetën.

Në pistë, çdo nxënës provoi të kapërcejë kufijtë e vet, të gjejë balancin, të rrëzohet, të qeshë dhe të ngrihet sërish – ashtu si çdo histori e vërtetë suksesi. E gjithë dita u mbush me energji pozitive, me bashkëpunim dhe me një atmosferë që e kujtonte se liria është e bukur pikërisht kur e ndajmë me njëri-tjetrin.

Përtej sportit, ishte një mësim i vogël jete:

Cuximi të çon përpara, përkushtimi të mban në rrugë, ndërsa komuniteti të jep forcë.



Loyola-Konvikt


Aventurat që lidhin fëmijët me natyrën dhe me njëri-tjetrin

Në Loyola-Gymnasium, mësimi nuk kufizohet vetëm brenda klasës — ai vazhdon në natyrë, në aventurë dhe në përvoja që formojnë karakterin. Këtë vit, tre aktivitete të veçanta u kthyen në momente të paharrueshme për nxënësit tanë, duke i mësuar ata bashkëpunimin, guximin dhe vlerësimin e mjedisit.

Një prej përvojave më të veçanta ishte aktiviteti i kayak-ut, ku nxënësit patën mundësinë të lundronin në ujëra të qeta, të njihnin bazat e sigurisë dhe të provonin një sport që zhvillon ekuilibrin, përqendrimin dhe besimin në vete. Për shumë prej tyre, ky ishte kontakti i parë me kayak-un — dhe një kujtim që do të mbetet gjatë.

Po aq e veçantë ishte edhe mbrëmja në Prevallë, ku fëmijët përjetuan një natë të ngrohtë në natyrë. Ata përgatitën grill, luajtën lojëra grupore, kënduan dhe krijuan momente që forcuan miqësitë dhe frymën e komunitetit. Në dritën e zjarrit dhe nën qiellin e hapur, mbrëmja u shndërrua në një përvojë të pastër gëzimi dhe bashkimi.

Eksplorimi vazhdoi me vizitën në Ujëvarat e Korishës, ku shtegu natyror, ajri i pastër dhe bukuria e ujit në rënie i ndihmuan nxënësit të vlerësojnë më shumë mjedisin dhe qetësinë që ofron natyra.




Shkolla e mesme “11 Marsi” dhe Loyola-Fillore vizitojnë Loyola-Profesionale

Gjatë këtij viti, Loyola-Profesionale mirëpriti disa vizita të rëndësishme nga institucione arsimore të Prizrenit, përfshirë shkollën e mesme “11 Marsi” dhe Loyola-Fillore. Nxënësit patën mundësi të njiheshin nga afër me laboratorët, pajisjet moderne dhe drejtimet profesionale që ofron institucioni ynë.

Gjatë këtyre vizitave, ata morën informacione mbi orientimin profesional, programet praktike dhe mundësitë që krijon arsimi teknik. Instruktorët e Loyola-Profesionale prezantuan mënyrën e zhvillimit të mësimit praktik, duke i lejuar nxënësit të provojnë pajisje dhe procese të ndryshme teknike.





ALG dhe Ambasada Gjermane Kur kultura, miqësia dhe rinia bashkojnë dy vende

KlanArena – Zëri i rinisë që nderoi 75-vjetorin e Kushtetutës dhe Unifikimit të Gjermanisë

Në kuadër të shënimit të 75 vjetorit të Kushtetutës gjermane dhe Unifikimit të Gjermanisë, nxënësit e Loyola-Gymnasium patën nderin të jenë pjesë e programit zyrtar në KlanArena. Performanca e tyre a cappella, përgatitur me përkushtim nën udhëheqjen e prof. Blondina Ademaj, krijoi atmosferën e ngrohtë të mirëseardhjes për të gjithë të ftuarit — mes tyre edhe vetë ambasadori gjerman, z. Jörn Rohde.

Kënga shqipe dhe himni gjerman u bashkuan për të treguar se dy kulturat, ndonëse të ndryshme, gjejnë vende të përbashkëta tek harmonia, respekti dhe arti.

Ndjenja që përjetuan nxënësit ishte e papërshkrueshme — një përzierje emocionesh, përgjegjësie dhe krenarie. Siç e përshkroi nxënësja Edra Bala, “ishte një ditë që do ta mbaj mend përgjithmonë”.

StreetFest – 25 vjet miqësi mes Gjermanisë dhe Kosovës

Në një tjetër moment të rëndësishëm, Loyola-Gymnasium mori pjesë si partner i përhershëm në festën e organizuar nga Ambasada Gjermane për të shënuar 25 vjet miqësinë mes dy vendeve.

Në StreetFest, të gjitha institucionet e ALG-së — Shkolla Filllore, Gjimnazi dhe Konvikti — u prezantuan me aktivitete muzikore, artistike dhe gjuhësore, duke e bërë hapësirën e festivalit një mozaik ngjyrash, tingujsh dhe krijimtarie.

Departamenti i gjuhës gjermane, së bashku me mësimdhënësit e muzikës dhe artit krijuan një program që tregoi qartë se miqësia mes Gjermanisë dhe Kosovës nuk është vetëm diplomaci — është përvojë njerëzore e jetuar përditë nga brezat e rinj.



Pedagogjia ignaciane në zemër të shkollës sonë


Një vizitë që forcoi misionin dhe frymën e edukimit

Shkolla jonë pati kënaqësinë të mirëpriste dy përfaqësues të Qendrës Pedagogjike Ignaciane ZIP nga Gjermania, Verena Urban dhe Kai Stenull, të cilët vizituan klasat, takuan nxënës, mësime dhe prindër dhe u njohën nga afër me jetën e gjallë të komunitetit tonë shkollor. Vizita e tyre u mbyll me mirënjohje të ndërsjellë dhe një ndjesi të thellë bashkëpunimi.

Në vijim të këtij bashkëpunimi, u zhvillua edhe punësoria e fundprillit dhe fillimmajit 2025, ku stafi ynë pati mundësinë të reflektojë mbi parimet që prej themelimit e frymëzojnë ALG-në: dinjiteti i çdo personi, përgjegjësia, shpresa, gabimi si pjesë e rritjes dhe zhvillimi përmes bashkësisë. Parime që e bëjnë pedagogjinë ignaciane një udhërrëfyes të fuqishëm për edukimin e të rinjve.

Siç thekson Diana Markaj, koordinatore e cilësisë në shkollën fillore: “Misioni ynë është që të rinjtë të rriten si mendimtarë të pavarur, persona me karakter të fortë dhe qytetarë të angazhuar që mësojnë të kontribuojnë për të mirën e përbashkët. Për këtë nevojiten mësime dhe motivuar, bashkëpunim me prindërit dhe një dëshirë e sinqertë për të mësuar nga vetë fëmijët.”

Me mirënjohje për Verena Urban dhe Kai Stenull, presim me entuziazëm hapat e radhës të këtij bashkëpunimi—sepse, siç na kujton Ignac de Loyola: “Shkolla është vendi ku mendon me mendjen tënde, ndihmon me zemrën tënde dhe shpërblen me duart e tua.”



Ekspertiza gjermane në ALG

Në fillim të këtij viti shkollor, kampusi i Loyola Gymnasium dhe Loyola Fillore u gjallërua nga prania e dy ekspertëve të shquar të Seniors Expert Service (SES) – z. Bernhard Merkelbach dhe znj. Gabriele Schnürlein-Land. Për një muaj të tërë (shkurt, 2025), ata u bënë pjesë e jetës sonë shkollore, duke ndarë dije, përvojë dhe frymë bashkëpunimi që i tejkalon kufijtë.

Z. Merkelbach, me mbi tri dekada përvojë në Zentrum für schulpraktische Lehrerbildung në Siegen dhe si ligjërues në Universitetin e Siegen, punoi me shumicën e mësimeve të Loyola Gymnasium, duke zhvilluar hospitime, sesione këshillimore dhe trajnime për përmirësimin e procesit mësimor. Ai mbajti takime individuale me mësimeve, ofroi këshilla për planifikimin dhe zhvillimin e orës, si dhe organizoi sesione të orientimit në karrierë për maturantët.

Znj. Schnürlein-Land, me mbi tridhjetë vjet përvojë si mësimeve e kimisë dhe biologjisë në Friedrich-Schiller-Gymnasium Ludwigsburg, ku ka shërbyer edhe si udhëheqëse e departamentit të shkencave natyrore dhe anëtare e menaxhmentit shkollor, bashkëpunoi me mësimeve të dy niveleve të Loyola-s. Ajo ofroi mbështetje në zhvillimin metodologjik, mësimin e bazuar në projekte dhe menaxhimin kreativ të klasës.

Ekspertiza dhe përkushtimi i tyre lanë gjurmë të thellë në komunitetin tonë arsimor, duke frymëzuar mësimeve dhe nxënësit drejt një arsimi më bashkëkohor, reflektues dhe me shpirt bashkëpunimi.



Loyola & Hildesheim

Kur profesionistët rriten së bashku dhe kulturat bashkohen

Në arsimin e mirë, zhvillimi profesional nuk ndodh vetëm brenda mureve të shkollës — ai ndodh aty ku njeriu guxon të dalë jashtë zonës së vet të rehatisë, të vëzhgojë, të mësojë dhe të ndajë. Pikërisht këtë frymë përjetuan mësime të Loyola-Gymnasium gjatë vizitës së tyre në Hildesheim dhe Hannover, si pjesë e projektit ndërkombëtar International Teaching Partnership.

Nga data 23–29 mars 2025, prof. Maksut Pirku, prof. Besnik Dakaj, mësuesja Bardha Ademaj dhe mësuesja Hygerta Thaçi, të prirë nga prof. Vezire Krasniqi, patën mundësinë të: observojnë orë në Gjymnazin Andreanum dhe shkollën tërëditore Alter Markt, të diskutojnë me kolegë gjermanë për qasje bashkëkohore në pedagogji dhe të vizitojnë universitetet partnere në Hildesheim dhe Hannover. Përtej aspekteve profesionale, ata zbuluan kulturën, ritmin dhe historinë e këtyre qyteteve, duke e përjetuar arsimin si një udhëtim të plotë — akademik dhe njerëzor.

Ndërkohë, në Prizren, gjatë shtatorit dhe tetorit, studentët nga Hildesheim dhe Hannover përfunduan me sukses praktikën e tyre në Loyola-Gymnasium dhe Loyola-Fillore. Tri javë punë, vëzhgim dhe reflektim, i ndihmuan ata të shohin nga afër se çfarë do të thotë mësimdhënie me përkushtim, përgjegjësi dhe profesionalizëm — duke e quajtur këtë përvojë një nga më të vlefshmet në formimin e tyre si mësues të ardhshëm.

Ajo që ka nisur si një partneritet akademik është shndërruar në një hapësirë të përbashkët mësimi, reflektimi dhe rritjeje.

ALG dhe Universiteti i Hildesheim-it po ndërtojnë së bashku jo vetëm profesionistë të rinj — por edhe ura miqësie, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi afatgjatë.



Një ditë e paharrueshme me MSU KFOR

Më 12 dhjetor 2024, nxënësit e klasave të pesta të Loyola-Fillore kaluan një ditë plot gëzim dhe emocion në vizitën e tyre te MSU KFOR. Mikpritja e ngrohtë, lojërat dhe surprizat krijuan kujtime të bukura që fëmijët do t'i mbajnë gjatë në mendje.

Kjo përvojë u mundësua falë bashkëpunimit të shkëlqyer me ekipin e misionit: Ten. Kol. Antonio Citarella për pritjen, Magj. Anna Zoppellaro për organizimin e përkryer, si dhe Nënkolonelin D'Aquila Davide dhe Babagjyshin e mrekullueshëm, Angelo Russello, të cilët i dhuruan fëmijëve çaste të veçanta.

Siç e thekson M. Lindita Spaqi, falënderimi i shkon të gjithëve — stafit CIMIC, mësimdhënësve dhe personelit mbështetës — që e shndërruan këtë ditë në një përvojë të gëzueshme dhe me vlerë për fëmijët tanë.



Nga Prizreni në Mostar Një udhëtim që ndërton ura

Në kuadër të programit Superschools – Peacebuilders 2.0, udhëtimi nga Prizreni në Mostar u shndërrua në një përvojë domethënëse për nxënësit e Loyola-Gymnasium. Miqësia nisi me vizitën e nxënësve të Gimnazija Mostar në Prizren, ku ata u njohën nga afër me kulturën, historinë dhe jetën shkollore, duke marrë pjesë në aktivitete që promovuan dialogun ndërkulturor dhe ndërtimin e paqes.

Vazhdimi i shkëmbimit u realizua nga 02 deri më 09 prill, kur 14 nxënës të Loyola-Gymnasium, të shoqëruar nga prof. Arbër Bytyçi dhe prof. Durim Shehu, vizituan Mostarin. Përmes diskutimeve, aktiviteteve kreative dhe eksplorimit të qytetit historik, të rinjtë ndërtuan miqësi të reja dhe thelluan kuptimin për bashkëjetesën dhe paqen. Ky udhëtim mbetet një hap i rëndësishëm drejt krijimit të lidhjeve të qëndrueshme mes të rinjve të rajonit.



Iniciativa e aftësimit profesional në Gjimnazin Loyola – Rrugëtimi i përbashkët drejt karrierës

Iniciativa e aftësimit profesional prej vitesh është një shtyllë kyçe e orientimit profesional në Gjimnazin Loyola. Nën udhëheqjen e prof. Shpres Zeka Karanezit, programi i mbështet maturantët në hapat e tyre të parë drejt tregut të punës.

E themeluar në vitin 2009 nga z. Alfons Tentrup, kjo nismë është zgjeruar vazhdimisht. Sot, 26 kompani prezantojnë 30 profesione praktike, duke krijuar një rrjet që u ka mundësuar mbi 200 nxënësve të gjejnë një vend të përshtatshëm të trajnimit profesional në rajonin e Oelde-s.

Procesi përgatitor fillon shumë përpara intervistave: përvetësimi i gjuhës gjermane (DSD I/II), hartimi i CV-ve profesionale, shkrimi i letrave motivuese dhe ushtrimet e intervistave janë pjesë thelbësore të përgatitjes. Në këtë mënyrë, nxënësit hyjnë të sigurt në bisedë me kompanitë.

Pas pranimeve, fillon pjesa më kërkuese: përgatitja e dokumenteve dhe aplikimi për vizë – shpesh paralel me periudhën intensive të përgatitjes së maturës.

Megjithë sfidat, iniciativa mbetet një projekt që sjell gëzim dhe krenari. Momenti i nisjes së maturantëve drejt kapitullit të ri të jetës mbetet gjithmonë i paharrueshëm.



Miqtë dhe përkrahësit e Asociation “Loyola-Gymnasium” e. V.



Qëllimi i shoqatës është promovimi dhe mbështetja e Asociation “Loyola-Gymnasium” (ALG).

Ajo synon gjithashtu të ndërmjetësojë dhe mbështesë kontaktin ndërmjet nxënësve të Loyola-Gymnasium si dhe shkëmbimet e tyre brenda dhe jashtë Kosovës.

Qëllimi i statutit është në veçanti edhe sigurimi i burimeve materiale dhe financiare, që mundësojnë ndërtimin ose rregullimin, blerjen e pajisjeve të nevojshme, bursa dhe gjëra të ngjajshme.

Kështu shkruan edhe në §2, Qëllimi i statutit të shoqatës mbështetëse, shoqatë e cila u themelua më 22 mars 2007 si një shoqatë e regjistruar në Oelde. Objektivat e shoqatës arrihen përmes donacioneve dhe kontributeve të më shumë se 225 anëtarëve të saj.

Organet e shoqatës përfshijnë mbledhjen e përgjithshme dhe bordin. Në mbledhjen e përgjithshme, e cila mbahet një herë në vit, anëtarët njoftohen për aktivitetet e shoqatës dhe Asociation “Loyola-Gymnasium” si dhe mbahen zgjedhjet e ardhshme për bordin, i cili sipas statutit zgjidhet për katër vite. Bordi ekzekutiv aktualisht përbëhet nga Alfons Tentrup (kryetar), Gresa Kabashi (zëvendëskryetare), Alban Ukiqi (arkatar) dhe Dirk Haberecht (sekretar). Bordi plotësohet nga katër anëtarë të tjerë si Arbër Gegaj, Dr. Frank Röschinger, Peter Tiggesbäumker dhe Mentor Ukimeri. Bordi drejton punët e shoqatës dhe kryen të gjitha detyrat e nevojshme administrative.

Shoqata mbështetëse Miqtë dhe përkrahësit e Asociation “Loyola-Gymnasium” e. V., e njohur shkurt si FFALG, është një organizatë që ka një vend në shoqatën bartëse ALG, e cila mban një mbledhje të përgjithshme të anëtarëve të paktën një herë në vit dhe gjithashtu zgjedh bordin e shoqatës bartëse.

Projektet që mbështeten nga shoqata mbështetëse në përputhje me statutin janë të natyrave të ndryshme dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë nga këto projekte përfitojnë nxënësit e ALG-së. Këto përfshijnë ndër të tjera:

- Bursa për fëmijët e familjeve në nevojë
- Trajnim të mësimdhënësve dhe edukim të mëtijshëm
- Shkëmbime të nxënësve dhe udhëtime shkollore
- Projektimin e kopshtit të shkollës
- Sigurim të materialeve të ndryshme mësimore
- Blerje të pajisjeve
- Plotësime në bibliotekën e shkollës
- Krijimin e qendrës së shkollimit profesional “Loyola-Profesionale”
- Iniciativën e shkollimit profesional me Gjermaninë



Të gjithë ata që së bashku me ne dëshirojnë të përkrahin vizionin e shoqatës mbështetëse “Fëmijët kanë nevojë për një të ardhme”, janë të mirëseardhur në çdo kohë. Shoqata mbështetëse FFALG njihet si një organizatë jofitimprurëse dhe për këtë arsye ka të drejtë të lëshojë konfirmime të donacioneve.

Alfons Tentrup
Shoqata mbështetëse FFALG



Tri javë përvojë dhe frymëzimi në Thüringen

Në nëntor 2024 patamundësinë të përfaqësoj ALG – Loyola Gymnasium në programin e hospitimit të PAD/KMK në gjimnazin historik Salzmannschule Schnepfenthal në Thüringen, një institucion me mbi 230 vite traditë arsimore.

Gjatë tri javëve ndoqa orë të gjuhës gjermane, anglishtes, spanjishtes, japonishtes, matematikës, muzikës dhe shumë lëndëve të tjera, duke parë nga afër metoda të ndryshme mësimdhënieje dhe përdorimin kreativ të mediave. Trajnimet dhe konferencat e organizuara nga Ministria e Arsimit e Thüringenit — veçanërisht ato mbi inteligjencën artificiale dhe inovacionin didaktik — e pasuruan më tej këtë përvojë.

Programi përfshinte edhe vizita kulturore, nga muzeu i Bach-ut dhe ai i Goethe-s, deri te një ditë e paharrueshme në Berlin, në 35-vjetorin e rënies së Murit. Një moment i veçantë ishte prezantimi im për Kosovën dhe ALG-në në aulën e shkollës gjermane, ku nxënësit dhe mësimdhënësit u njohën nga afër me shkollën tonë dhe vendin tonë.

Kjo periudhë ishte një mundësi e çmuar për rritje profesionale, reflektim dhe frymëzim — një përvojë që do të ndikojë drejtpërdrejt në punën time të përditshme në ALG.



Shkëmbimi ndërkulturore Gemünden–Prizren

Shkëmbimi ndërkulturore mes nxënësve të Friedrich-List-Gymnasium Gemünden dhe Loyola-Gymnasium Prizren, i udhëhequr nga prof. Shpres Zeka Karanezi dhe prof. Nesrin Limani, u shndërrua në një përvojë të pasur me kulturë, reflektim dhe miqësi të singërta. Vizita në Rezidencën e Würzburgut, bunkerin e Lengfurt-it dhe memorialin Point Alpha u dhanë nxënësve një pasqyrë të thellë mbi historinë gjermane, paqen dhe ndarjet që kanë formësuar Evropën.

Po aq domethënëse ishin momentet e përditshmërisë: dita familjare në shtëpitë pritëse, ecjet në natyrë, vizita në sinagogën e Lautenbach-ut dhe mbrëmja përmbyllëse me grill, vallëzim dhe prezantime kreative. Ky shkëmbim dëshmoi se mësimi më i vlefshëm ndodh përmes takimeve njerëzore — aty ku ndërtohen ura, lind mirëkuptimi dhe forcohet vizioni për një Evropë të hapur dhe të bashkuar.



Vullnetarizmi në veprim

Nxënësit e Loyola-Gymnasium në shërbim të komunitetit

Në kuadër të traditës së përvitshme të shërbimit ndaj komunitetit, gjatë vitit shkollor 2024/25 nxënësit e Loyola-Gymnasium u angazhuan si vullnetarë në Qendrën për Projekte Sociale – Concordia. Nën koordinimin e prof. Ermira Mazreku, bashkëpunimi u zhvillua me sukses përgjatë gjithë vitit, duke u kthyer në një përvojë me vlerë për të gjithë të përfshirët.

Vullnetarët tanë, të organizuar në grupe, asistuan në një sërë aktiviteteve edukative dhe sociale: ndihmuan fëmijët në detyrat e shtëpisë, mbështetën zhvillimin e aktiviteteve mësimore e shoqërore dhe kontribuan në fusha të ndryshme sipas aftësive të tyre — nga gjuha dhe shkencat, te sporti, arti dhe lojërat zhvillimore.

Ky angazhim u mirëprit nga stafi i Concordias, të cilëve nxënësit ua lehtësuan punën e përditshme dhe i pasuruan aktivitetet me energji pozitive dhe kreativitet. Njëkohësisht, për nxënësit vullnetarë kjo përvojë u bë një mësim i gjallë mbi empatinë, përgjegjësinë dhe rëndësinë e kontributit ndaj tjetrit.





“Kursejmë dhe dhurojmë”

Një mësim i vogël me dashuri të madhe

Në klasat e dyta të Loyola Fillore, mësimi për planifikimin dhe kursimet u shndërrua në një përvojë që, siç thekson mësuesja Katarina Gojani, “i mësoi fëmijët se mirësia rritet duke e ndarë”.

Si pjesë e lëndës Shkathtësi për jetë, nxënësit ndërmorën një nismë tre mujore: të kursenin para me qëllim t'i dhuronin për fëmijët pa kujdes prindëror. Fëmijët nisën me shumë entuziazëm, shpesh duke dhënë më shumë sesa ishte kërkuar — nga dëshira e pastër për të sjellë lumturi tek dikush tjetër.

Pas tre muajve, ata vizituan organizatën OFAP dhe dorëzuan kontributin e tyre simbolik, por të mbushur me dashuri dhe kuptim. Për shumë prej tyre, ky ishte momenti kur kuptuan se një gjest i vogël mund të bëjë një ndryshim të madh.

Fëmijët u shpërblyen me një shëtitje të bukur pranverore, duke shijuar natyrën dhe shoqërinë e njëri-tjetrit — një fund i ngrohtë për një projekt që preku zemrat e të gjithëve.



Loyola–Filllore promovon sportin për një botë më të gjelbër

Në Shkollën Filllore “Loyola”, sporti u bë pjesë e një iniciative që ndërthur lëvizjen me kujdesin ndaj mjedisit. Duke iu bashkuar fushatës “Sporti për një botë më të gjelbër”, nxënësit punuan në video kreative ku shpalosën ide dhe mesazhe se si aktiviteti fizik ndikon në shëndet dhe në mbrojtjen e ambientit.

Gjatë datave 17–21 mars, ata prezantuan punimet e tyre, ndërsa videot më të pëlqyera u vlerësuan për kreativitet dhe ndikim. Projekti u realizua në bashkëpunim me mësuesin e sportit, prof. Valon Bajraktari, dhe video realizuesin Leonard Lleshi, nën koordinimin e mësueses Bardha Ademaj.



“Unë ushqehem, tjetrin ndihmoj”

Një mësim zemre dhe solidariteti

Nën moton domethënëse “Unë ushqehem, tjetrin ndihmoj”, nxënësit e klasave të katërta të Loyola Fillore realizuan një aktivitet që u shndërrua në shembull të bukur të bashkëpunimit mes shkollës, fëmijëve dhe prindërve.

Siç tregon mësuesja Elizabeta Spaqi, projekti lindi në kuadër të lëndës Shoqëria dhe Mjedisi, ku nxënësit mësojnë për traditat, zakonet dhe ushqimet tona tradicionale. Prindërit u bashkuan me shumë vullnet, duke gatuar në shtëpi ushqime tradicionale që më pas fëmijët i shitën në festën e Ditës së Shkollës.

Qëllimi ishte i qartë dhe fisnik: të mbledheshin fonde për t'i ndihmuar ata që përballen me vështirësi apo sëmundje të rënda. Fëmijët treguan përgjegjësi dhe ndershmëri të admirueshme — duke i shitur ushqimet me buzëqeshje dhe përkushtim, dhe duke u siguruar që çdo vizitor të kontribuonte.

Prindërit, gjyshërit dhe të gjithë të pranishmit u treguan jashtëzakonisht bujarë. Edhe ata që nuk merrnin ushqime, dhuronin me zemër të hapur, duke e kthyer këtë aktivitet në një ditë solidariteti të vërtetë.

Ky projekt, i thjeshtë në dukje, mbarti mesazhin më të madh: se humaniteti mësohet duke e jetuar. Dhe fëmijët tanë, me ndihmën e prindërve dhe mësuesve, dhanë një shembull të shkëlqyer se si mirësia mund të bëhet pjesë e çdo dite.



Për një buzëqeshje më shumë

Vizita e nxënësve në shtëpinë e të moshuarve

Me rastin e festave të fundvitit, nxënësit e klasave të katërta patën një përvojë të veçantë që, siç thekson mësuesja Elizabeta Spaqi, “i mësoi fëmijët se sa pak mjafton për t’ia bërë dikujt ditën më të ngrohtë”.

Ata vizituan Motrat e Nënë Terezës dhe personat e moshuar që jetojnë në Shtëpinë e Dashurisë — njerëz pa përkrahjen e familjes, por me një zemër të madhe që pret afërsi dhe kujdes. Fëmijët performuan pika muzikore, dhuruan kartolina të punuara me dorë dhe paketa të përgatitura me prindërit në shtëpi.

Momenti më i bukur? Buzëqeshjet e të moshuarve dhe dritat në sytë e fëmijëve — një shkëmbim mirësie që vlen më shumë se çdo dhuratë.



Këndi i Mirësisë

Kur gjestet e vogla krijojnë ndryshime të mëdha

Në atmosferën e gjallë të aktiviteteve shkollore, një nismë u veçua për thjeshtësinë, ngrohtësinë dhe ndikimin e saj: Këndi i Mirësisë. Ky aktivitet u kthye në një shembull të qartë se si kreativiteti i të rinjve, i bashkuar me zemër dhe dashuri, mund të sjellë dritë atje ku ka nevojë.

Nxënësit punuan me entuziazëm për të dizajnuar vetë mbishkrimet e bluzave, duke i shtypur me kujdes dhe përkushtim. Në Ditën e Dyerve të Hapura, këto bluza u ekspozuan dhe u shitën me çmime simbolike — një proces që solli gëzim, bashkëpunim dhe një ndjenjë të thellë që po bëhej diçka e mirë për të tjerët.

Falë punës së nxënësve, mbështetjes së mësimdhënësve dhe një kontributi vullnetar nga psikologja e shkollës Nora Hoxha, u grumbulluan 600 euro. Këto mjete iu dhuruan Qendrës së Strehimit për Gra dhe Fëmijë në Prizren, duke u kthyer në ndihmë konkrete për ata që përballen me sfida të mëdha në heshtje.

Këndi i Mirësisë mbetet një kujtesë e bukur se shoqëria ndërtohet me vepra, me duar që punojnë dhe me zemra që ndjejnë.



Muaji Rozë në Loyola-Gymnasium Kur ndërgjegjësimi bëhet vepër

Tetori i vitit 2024 në Loyola-Gymnasium u shndërrua në një muaj reflektimi, solidariteti dhe humaniteti. Ditët e Ndërgjegjësimit dhe Informimit për Kancerin e Gjirit u kthyen në një nismë të fortë edukative dhe sociale, ku nxënësit tanë – sidomos ata të klasave të dymbëdhjeta – treguan pjekuri, përgjegjësi dhe vullnet për të bërë ndryshim.

Me përkushtim të veçantë, nxënësit përgatitën ligjërata informuese rreth shkaqeve, simptomave dhe mënyrave të parandalimit të kancerit të gjirit, duke sjellë një qasje të thjeshtë dhe të kuptueshme për bashkëmoshatarët e tyre.

Në krah të pjesës edukative, u organizuan edhe aktivitete humanitare: shitja e ëmbëlsirave, vizatimi i portreteve dhe nisma të tjera kreative që mblodhën fonde me zemër të madhe. Falë përkushtimit të nxënësve dhe mbështetjes së komunitetit, u siguria një shumë prej 1,200 euro, e cila iu dorëzua organizatës HAVE HOPE – një gjest i vogël në shifër, por i madh në mesazh: askush nuk është i vetëm në këtë betejë.

Ky projekt nuk do të ishte i mundur pa udhëheqjen e palodhshme të mësimdhënëses së biologjisë Gresa Çoçaj-Shala, e cila me profesionalizëm dhe shpirt human e udhëhoqi nismën drejt suksesit, duke frymëzuar nxënësit të përdorin dijen për të bërë mirë.

Videoja përmbyllëse e përgatitur nga nxënësja Ensuida Gallopeni ruan të gjitha emocionet e ditëve të përkushtimit — fytyra të buzëqeshura, dritë, punë ekipore dhe një shkollë që rrit qytetarë të vetëdijshëm.

Në Loyola-Gymnasium besojmë se arsimi është më i vlefshëm kur prek jetët përtej bankave të klasës.



Loyola–Konvikt: Mirësia që udhëton nga zemra te zemrat e fëmijëve në nevojë

Në prag të festave të fundvitit, komuniteti i Loyola–Konviktit u bashkua në një nismë me zemër të madhe: mbledhjen dhe dhurimin e paketave për fëmijët në nevojë. Nxënësit e konviktit, të udhëhequr nga edukatorët dhe stafi mbështetës, përgatitën me kujdes dhurata që përfshinin lodra dhe ushqime, duke dëshmuar se solidariteti është pjesë e rëndësishme e edukimit që marrin në Loyola.

Procesi i mbledhjes dhe paketimit u shndërrua në një moment të ngrohtë bashkëpunimi. Çdo nxënës kontribuoi sipas mundësive të veta, duke kuptuar se edhe një gjest i vogël mund të sjellë gëzim të madh te dikush që ka nevojë. Nisma u përmbyll me vizitën në institucionet lokale që kujdesen për fëmijët në situata të vështira, ku dhuratat u dorëzuan me buzëqeshje dhe urime të singërta.

Për nxënësit e konviktit, kjo përvojë ishte më shumë sesa një aktivitet humanitar; ishte një mësim i gjallë mbi empatinë, përgjegjësinë dhe fuqinë e veprimit të përbashkët.

Loyola–Konvikt mbetet i përkushtuar të jetë jo vetëm një vend banimi, por një komunitet që edukon zemrën po aq sa mendjen.



PROJEKTET E ALG-SË



Muzikë në kohë të lirë

Hapësira ku talentet marrin jetë

Në ALG “Loyola-Gymnasium”, arsimi nuk përfundon me mësimet e ditës. Siç thekson mësimdhënësi i edukatës muzikore Berat Tafallari, përgjegjës i programit artistik, shkolla ka krijuar një hapësirë të dedikuar ku nxënësit zhvillojnë talentet e tyre përmes muzikës, baletit dhe këndimit — një ambient ku kreativiteti, disiplina dhe gëzimi ndërthuren natyrshëm.

Që nga viti 2015, falë vizionit të drejtorit Axel Bödefeld dhe bashkëpunimit të ngushtë me motrën Lindita Spaqi, është ngritur një program i strukturuar që u ofron nxënësve mësim individual dhe grupor në piano, kitarë, violinë, flaut, çelo, balet dhe këndim. Ky program është bërë pjesë e pandashme e jetës shkollore, duke i ndihmuar nxënësit të eksplorojnë talentet e tyre dhe të fitojnë besim në veten.

Momenti më i bukur i këtij angazhimi janë koncertet vjetore, ku fëmijët paraqesin para komunitetit rezultatet e punës së tyre të përkushtuar. Këto performanca sjellin emocione, gëzim dhe një ndjenjë të fortë arritjeje — duke e bërë artin një pjesë të gjallë të përvojës së tyre shkollore.



Ditët e Karrierës

Kur e ardhmja fillon sot

Në fillim të prillit, Loyola-Gymnasium u mbush me energji, entuziazëm dhe pyetje që tingëllonin si hapa drejt së ardhmes. Projekti “Ditët e Karrierës” u kthye në një prej ngjarjeve më të rëndësishme të vitit shkollor, duke bashkuar në një vend universitete nga Kosova, Shqipëria dhe Gjermania, si dhe qindra nxënës që kërkonin të zbulojnë rrugët e tyre profesionale.

Salla AULA u transformua në një panair të gjallë idesh dhe mundësish, ku çdo tavolinë përfaqësonte një horizont të ri, një ëndërr që priste të merrte formë. Nxënësit e klasave të 11-ta dhe 12-ta patën mundësinë të takohen nga afër me përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, të informohen për programet studimore, bursat dhe mundësitë ndërkombëtare, por mbi të gjitha – të frymëzohen për të menduar më tej, më thellë, më guximshëm.

Në secilën bisedë, në secilën pyetje, ndjehej dëshira për të bërë zgjedhjen e duhur, për të ndërtuar një rrugë që përputhet me talentin dhe pasionin personal. Ishte një ditë ku shpresa dhe ambicia u takuan, një ditë ku u kuptua se karriera nuk fillon pas shkollës – ajo fillon pikërisht aty, në vendimin për të ëndërruar dhe për të punuar për të.

“Ditët e Karrierës” janë më shumë se një panair universitar; ato janë një thirrje për vetëdije, zgjedhje dhe vizion. Ato përforcojnë misionin e Loyola-Gymnasium: të formojë njerëz që jo vetëm ndjekin rrugë të suksesshme, por edhe e ndërtojnë me integritet dhe pasion vetë rrugën e tyre.



Gara e Vallëzimit

Kur pasioni bëhet art në lëvizje

Nën kujdesin e profesorit të Edukatës Fizike prof. Mentor Ukimeri u organizua Gara e Vallëzimit, një aktivitet që e solli shkollën në ritmin e muzikës, energjisë dhe shpirtit rinor.

Këtë vit, vajzat e klasave 12B, 12C, 12D, 12E dhe 11A u përfshinë në një sfidë artistike që shkoi përtej garës – ishte një shprehje e pasionit dhe e harmonisë në lëvizje. Sallat e shkollës u mbushën me ngjyra, buzëqeshje dhe duartrokitje, ndërsa publiku në Facebook dhe Instagram mori rolin e jurisë për të zgjedhur performancën më të pëlqyer.

Procesi i votimit ishte një përvojë emocionuese: çdo “❤️” përfaqësonte një zë, një mbështetje, një ndjenjë. Pikët e publikut u kombinuan me ato të jurisë profesionale, duke e bërë garën edhe më të drejtë e dinamike. Në fund, klasa 12B dhe klasa 12E u shpallën fituese të përbashkëta të vendit të parë, pasi morën numër të barabartë pikësh – një dëshmi e qartë se pasioni nuk matet me numra, por me zemër.

Çmimet monetare të ofruara nga St. Anna Familie (50 EUR; 100 EUR; 150 EUR; 200 EUR dhe 250EUR), ishin një mënyrë e bukur për të vlerësuar jo vetëm fituesit, por edhe përpjekjen dhe kreativitetin e çdo klase – FALEMINDERIT St. Anna Familie.

